

GJYMTYRËT E DYTA

Kryefjala dhe kallëzuesi, në fjalinë me dy gjymtyrë kryesore, përbëjnë strukturën ose boshtin e fjalisë, sepse janë elementet më të rëndësishme dhe më të domosdoshme të saj. Gjymtyrët e tjera që quhen gjymtyrë të dyta lidhen me kryesoret nga ana strukturore e kuptimore dhe i zgjerojnë e i përcaktojnë më tej ato. Gjymtyrët e dyta janë në raporte varësie me gjymtyrën me të cilën lidhen. Emërtimi gjymtyrë të dyta ka të bëjë kryesisht me rolin që ato luajnë në organizimin dhe ndërtimin e fjalisë dhe jo me peshën që kanë në përmbajtjen kuptimore të saj. Pra, ato quhen kështu jo se përmbajnë informacion të parëndësishëm, po se nga ana strukturore janë në një lidhje hierarkike më të ulët në raport me gjymtyrët kryesore të fjalisë, janë, pra, në lidhje varësie.

Pavarësisht nga informacioni plotësues që mund të sjellin gjymtyrët e dyta në një fjali, ato mund të mos jenë të domosdoshme për fjalinë, mund të hiqen dhe kuptimi i saj të mos priset: *Udhëtarët e tjerë panë njëri-tjetrin. E kalova me hap tëlehtë hapësirën ndarëse. Në mesnatë dera trokiti përsëri.* Fjalitë që dalin nga heqja e gjymtyrëve të dyta me shkronja të zeza janë po aq të plotkuptimshme sa dhe të mëparshmet: *Udhëtarët panë njëri-tjetrin. E kalova hapësirën ndarëse. Dera trokiti përsëri.*

Kur gjymtyrët e dyta shprehin një element të thënies që mban peshën kryesore kumtuese të saj, atëherë janë të domosdoshme dhe fjalia s'mund të ndërtohet pa to: *Kur ndodhi kjo? Natën udhëtuan ata?* Të dy rrethatorët e kohës janë të domosdoshëm, se mbajnë peshën kryesore të kumtimit: në këto fjali pyetet pikërisht për kohën. Në përgjithësi, rrethatorët e përcaktorët janë gjymtyrë që kanë lidhje më të çlirëta me fjalinë, gjymtyrë facultative të saj, po mund të jenë edhe të domosdoshme e pa to s'ndërtohet fjalia, sin ë shembujt që paraqitëm më lart dhe jo në pak raste të tjera: *Ne banojmë në qytet. *Ne banojmë. (?)*

Klasifikimi më i përhapur dhe më i njohur i gjymtyrëve të dyta është ndarja e tyre në tri kategori të mëdha: **përcaktorë, kundrinorë dhe rrethatorë.**

Ndër gjymtyrët e dyta, si gjymtyrë të lidhura ngushtë me fjalinë dhe të domosdoshme për të janë *kundrinori i drejtë dhe kundrinori i zhdrejtë: Studenti ngriti dorën.* Po të hiqet gjymtyra *dorën*, fjalia qoftë nga ana kuptimore, qoftë nga ana strukturore mbetet e mangët, nuk realizohet në gjuhën shqipe. Kështu ndosh edhe me fjalitë e tjera më poshtë, pot ë hiqen gjymtyrët me të zeza: *Takova nënën. Mëflihet. S'mërrihet. Studentët u janë përveshur mësimëve. Ju merreni me atletikë.*

KUNDRINORI

Kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që vihet në marrëdhënie objektore dhe lidhet me drejtim me gjymtyrën nga e cila varet. Ai varet nga gjymtyrë të shprehura me folje e me mbiemra. Në bazë të kriterit të shprehjes morfologjike kundrinori ndahet në: *kundrinor të drejtë, kundrinor të zhdrejtë (i cili ndahet në kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë dhe në kundrinor të zhdrejtë me parafjalë)*. Kundrinori i drejtë shprehet me format e rasës kallëzore pa parafjalë, kundrinori i zhdrejtë shprehet me format e rasës dhanore dhe kundrinori i zhdrejtë me parafjalë shprehet me forma të ndryshme të rasave emërore, gjinore, kallëzore e rrjedhore me parafjalë: **Shkakun e mori vesh më vonë. Ajo iu lut shoferit që të priste edhe pak. Ishte njohur me ushtarin.**

➤ Kundrinori i drejtë

Kundrinor i drejtë është emri në rasën kallëzore pa parafjalë që lidhet drejtpërdrejt me folje kalimtare veprorë dhe shënon zakonisht objektin mbi të cilin bie veprimi i foljes kalimtare. U përgjigjet pyetjeve me përemra: *kë?, cilin?, ç’?, çfarë?*.

Marrin kundrinë të drejtë:

- foljet kalimtare (veprorë);

- format e pashtjelluara të tipit: *për të larë, duke larë, me të larë, një të punuar e pa punuar;*

- foljet aspektore, që tregojnë mbarim a vazhdim veprimi e që ndiqen nga emra prejfoljorë asnjans në rrjedhore:

Ai e vazhdoi fjalën me një psherëtimë. Ne kurrë nuk niseshim për ta ngacmuar babanë. Më në fund pushoi së foluri budallallëqe. U lodhën së pari televizor.

Kundrinori i drejtë mund të përdoret edhe në fjali të paplota: *Kujdes librat. Amanet motrën.*

Kundrinor të drejtë mund të marrë edhe një shprehje onomatopeike me vlerë foljore: *Tërë natën rrinte zgjuar dhe kraf-kruf çakmakun për të parë orën.*

Karakteristikë për kundrinorin e drejtë është kthimi i tij në kryefjalë, kur folja kthehet nga forma veprorë në joveprorë: *Punëtorët kishin lëvruar tokat e reja. Tokat e reja u lëvruan nga punëtorët.*

Kundrinori i drejtë shprehet me:

a) emër(të shquar a të pashquar) në rasën kallëzore: 1. *Të dy vështronin zhubrat e valëve.* 2. *Në trup dalloj shenja kafshimesh.*

b) përemër: 1. *Këtës’ma ke thënë.* 2. *Nata e flokëve të saj mëmbuloi edhe mua.* 3. *Komandanti nuk tha asgjë.* 4. *Studentëte njihnin njëri-tjetrin.*

c) numëror me përdorim emëror: *Po të shumëzohet pesën me dy çfarë jep?*

ç) pjesë të emëruar të ligjëratës: 1. *Ju bëni tuajën, edhe unë timen.* 2. *Psenë se gjeni dot. I uruan mirëseardhjen.*

d) togfjalësh të qëndrueshëm: 1. *Luftonin krimbin e mëndafshit.* 2. *Plakut idhanë Medaljen e Trimërisë.*

dh) togfjalësh të lirë: 1. *Spiroja e dinte këtë mendim të Emës.* 2. *Nata dimërore kishte mbështjellëçdo gjë.*

*Kundrinori i drejtë mund të shenjohej me trajta të shkurtra të përemrit vetor të cilat, kur shoqërojnë kundrinorët e shprehur janë përsëritëse të kundrinës. në qoftë se kundrinori është përmendur në kontekst ose është i njohur për bashkëbiseduesin, aim und të mos shprehet, kurse trajta e shkurtër është e pamungueshme: 1. *I the Petritit të vijë? - I thashë.* 2. *Sapo mëtelefonuan.*

➤ Kundrinori i zhdrejtë

a) Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Është kundrinori që shprehet me format e rasës dhanore të emrit, të përemrit a të një fjale të emëruar. U përgjigjet pyetjeve *kujt?, cilit?*. Folja me të cilën lidhet kundrinori i rasës dhanore mund të jetë kalimtare ose jokalmimtare dhe në çdo diatezë. Ky kundrinor shenjohej gjithnjë nga trajta e shkurtër e përemrit vetor (me përjashtim të rasteve: a) kur ndiqet nga një pjesore: *U përurua lapidari kushtuardëshmorëve.* b) kur paraprihet nga një emër foljor me prapashtesën –je: *Dhënia e tokës fshatarëve u bë me ceremoni.*)

Varësisht nga konteksti mund të mungojë vetë kundrinori, kurse trajta e shkurtër është e pamungueshme:

1. *Nxënësit i dhuruan mësueses lule.* 2. *Thuaja mendimin gjithnjë në sy tjetrit.* 3. *Së keqes duhet t'i largohesh.* 4. *Asaj i shkëlqenin shumë flokët.* 5) *Ata i shtrënguan dorën njëri-tjetrit.* 6) *Ty as që duhet të të shkojë nëmend një gjë e tillë.* 7) *A-së nuk ia paske bërë mirë bishtin.* 8) *Më erdhi mirë kur dëgjova.*

b) Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Është mjaft i larmishëm dhe paraqitet me një shumëllojshmëri ndërtimesh. Ai varet nga folje kalimtare ose jokalmimtare dhe me mbiemra zakonisht foljorë, por edhe jofoljorë: 1. *S'doja të ndaheshanga të afërmit.* 2. *Rrugët e shtruara me kalldrëm gjëmonin nga hapat e kalimtarëve.*

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë shprehet me emër, me përemër dhe me togfjalësh të shoqëruar me parafjalë a lokucione parafjalore të ndryshme: *nga, te (tek), me, pa, me anën, për, mbi, nën, kundër, ndaj* etj.

a) 1. Merr **nga këto mollë**. 2. Kur fillove **nga puna**? 3. E njoh **nga tregimet** e të tjerëve. 4. Vajza me flokë e sy të zinj me siguri po shkonte **te motra**.

Kujdes! Kur emri i shoqëruar me parafjalë shënon një frymor, hyn në marrëdhënie kundrinore, kur shënon një send, hyn në marrëdhënie rrethanore. P.sh.: 1. Vajza me flokë e sy të zinj me siguri po shkonte **te motra**.(kundrinor); 2. U mbështet përsëri **te shtylla** elektrike.(rrethanor)

b) 1. Nusen e morën **me taks**i. 2. Baraka ishte ndërtuar me **dërrasa**. 3. I erdhi shumë keq **për gjyshen**. 4. **Pa shkollë** s'do të isha bërë ai që jam. 5. Hakmarrja do të bjerë e fortë **mbi ta**. 6. Kjo qetësi u kthye **në një tmerr** të vërtetë. 7. Rruga automobilistike dukej pothuaj e bardhë nën dritën e hënës.

c) 1. **Me anë të teletrikut** të dorës ai arriti të ndriçonte edhe skutat më të errëta të depos. **Në vend të drejtorit** foli sekretari.

ç) 1. U njoh me **tënëpërmjet internetit**. 2. U ngrit kundër mendimeve të shumicës. 3. Ai është i kujdesshëm **ndaj të tjerëve**. 4. Ecnin qorrazi **drejt së panjohurës**.